

**SHOQËRIA TREGTARE ME ORTAKËRI ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
“TOP FORM ALBANIA” SH.P.K
AKT THEMELIMI**

Në Durrës ,sot me datën 27.06.2018 ,(dymijë e tetëmbëdhjetë):

Me ane te ketij dokumenti te redaktuar ne 5 (pese) kopje origjinale midis:

“TOP FORM “ SRL (SHPK) , e perfaqesuar nga administratorja **Paola Minguzzi**, e lindur ne Ravenna (RA), me26.10.1967, rezident ne Saterno (RA), VIA Degli Angeli, nr 66,qytetare italiane, e identifikuar ne baze te leternjoftimit italian Nr.AT4231398 e vlefshme deri me 26/10/2023 si dhe ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise “TOP FORM” shpk, ne baze te vendit te asamblese te ortaleve date 02.06.2018;

*Vullnetin e saj të lirë , të plotë, të sinqertë dhe në iniciativën e lirë private

*Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi.

*Në ligjin Nr.9901 datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

*Në ligjin Nr .9723 datë 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit “

*Në ligjin Nr.7764 datë 02/11/1993 “Për Investimet e Huaja “

dhe në të Drejtën Ndërkombëtare Publike dhe Konventat ndërkombëtare të gjithëpranuara të Komunitetit European , vendos me anën e këtij Akti Themelimi ,te krijojnë Shoqërinë tregtare me ortakëri dhe me përgjegjësi të kufizuar „TOP FORM ALBANIA“ SH.P.K .

1. Krijohet Shoqëria tregtare me emrin „TOP FORM ALBANIA“ SH.P.K. emërtim i cili do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.
2. Kohezgjatja e aktivitetit fiksohet deri me 31 Dhjetor 2038, por mund te shtyhet ne unanimitet nga ortakët.
3. Shoqeria ka per objekt te aktivitetit te saj:
Aktiviteti i prodhimit te arredimeve dhe dhe prodhimeve te drurit dhe materialeve te tjera ne pergjithesi per sektorin civil, industrial dhe te transporteve. Ndertimi dhe/ose blerja, furnizimi, marrja me qera dhe shitja e pajisjeve dhe sistemeve te sigurise dhe telekomunikacioneve, te aparaturave elektrike dhe/ose elektronike ne pergjithesi, si dhe marrjen e ekskluziviteve per tregtimine produkteve te ngjashme; mund edhe te ofroje sherbime teknike, te asistencesdhe te kontrollit ne lidhje me te njejtat produkte; instalimin, mirembajtjen, riparimin, transformimin dhe administrimin e impianteve te prodhimit, te transportit, te shperndarjesdhe perdorimit te energjise;

Paola Minguzzi

Sherbimet e sigurise, rojeve te dyerve, ruajtjes dhe sigurise, kunder grabitjeve, kundra vjedhjeve (pervec autorizimeve me ligj) dhe sherbimeve te garderoberes, furnizimi me sisteme te sigurise per telekontrollin, kundra zjarrit, kunder hyrjes me dhune, rrjedhjes se gazit, impiantet e fikjes, mbrojtjet e sistemeve EDP, analizat e risqeve dhe aplikimi i sistemeve te sigurise;

Realizimi, rindertimi, ristrukturimi, mirembajtja dhe dhe administrimi i cdo pasurie te paluajtshme, si me interes publik ashtu dhe privat; ndertimi, furnizimi, montimi dhe mirembajtja e impianteve teknike, hidrosanitare, hidrotermosanitare, si dhe ato te transportit, trajtimit, te perdorimit, mbledhjes dhe konsumit te ujit;

Sherbimet e informatikes, telematikes, robotikes, kerkimi dhe transferimi i teknologjive, mirembajtja; asistenca, perditesimi hardware dhe software, zhvillimi software dhe zhvillimi i rrjeteve telematik; kurset e formimit profesionalte cdo lloj urdheri dhe shkall, perpunimin e te dhenave kontabel si dhe te pagave dhe kontributeve, marketing, sherbimeve te promocionit dhe imazhit; sherbimet publicitare ne pergjithesi;

Trajnimin dhe stervitjen e personelit; tregtimin e produkteve dhe makinerive me dhe pa perfaqesi edhe kur s'kane te bejne me aktivitetet e mesiperme;

Aktiviteti i kerkimeve projektive, zbatimit, asistences teknike, konsulences dhe eksperimentimit dhe do te prodhoje materiale inovative dhe metodave per perdorimin e tyre duke e zgjeruar aktivitetin e tregtimit te produkteve dhe artikujve qe kane lidhje me to;

Aktivitetin e zhvillimit, prodhimit dhe tregtimit te materialeve dhe teknologjike te sektorit te energjive te rinovueshme, nga biomasat dhe eko te perpuethshme; Aktivitet bujqesor, te transportit dhe te prodhimit te energjise.

Të kryejë çdo veprim tjetër në përmbushje të interesave dhe nevojave të anëtarëve të saj sipas dispozitave të statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e favorizon atë. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi. Çdo aktivitet tregtar që nuk ndalohet me ligj.

4. **Selia Qendrore** e Shoqërisë është në adresën: Tirane, Rruga e Kavajes (objekt i pa hipotekuar), zk.8380, pallat i shoqerise „2AT Construksion“ shpk, nr 4, seksioni 1, kati dyte.

Paolo Amuse

- Asambleja e ortakëve ka të drejtë të hapë filiale e zyra përfaqëse si dhe t'i shkrijë ato.
5. Kapitali shoqëror fillestar është në vlerën 100'000 Lek (njëqindmijë), e barabartë me 1 (një) kuota, vetëm e ortakut të vetëm " TOP FORM" srl = 100 % të kapitalit shoqëror.
6. Administrimi dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohen një Administratori të Vetem, që mund edhe mos të jetë ortak.
Administratori i Vetem emërohet për maksimumi 5 vjet, përveç rasteve kur jep dorëheqjen ose shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve.
Administratori i Vetem emërohet znj. **Paola Minguzzi** të cilit i jepet e drejta e firmës dhe e përfaqësimit të shoqërisë.
Administratori i Vetem ka të gjithë kompetencat për realizimin e objektit të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave të dhëna nga ky Akt dhe nga Statuti ekskluzivisht Asamblese së Ortakëve dhe organeve të tjera të shoqërisë.
7. Viti ekonomik ushtrimor fillon më 28.06.2018 dhe mbaron më 31 Dhjetor.
8. Në përfundim të vitit ushtrimor, pas aprovimit të bilancit, Asambleja mund të vendosë ndarjen e fitimit neto tek ortakët e vetëm . Ky fitim mund të transferohet lirisht jashtë Shqipërisë konform legjislativës në fuqi. Për humbjet përgjigjet ekskluzivisht shoqëria me kapitalin e saj.
9. Ortaku dhe administratori janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin mbi dokumentacionin, të dhënat, njohuritë dhe eksperiencat e fituara gjatë aktivitetit të shoqërisë, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurojë për të evituar përhapjen, qoftë edhe pjesore, të tyre.
Ata janë përgjegjës për pasoja të mundshme negative nga shkelja nga ana e tyre e sa me sipër thënë.
10. Përsa nuk specifikohet shprehimisht në këtë akt, vlejne normat e Statutit bashkëngjitur.
11. Akti të Themelimit në gjuhën shqipe do t'i bashkëngjitet kopja në gjuhën italiane.
Ky akt nënshkruhet në prani të përkatësve të ligjor Oert Vezi.

ORTAKU I VETEM

"TOP FORM " SRL (SHPK)

Përfaqësuar nga

PAOLA MINGUZZI

Paola Minguzzi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
Repertor nr. 1254
Koleksion nr. 836/A



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Durres, sot me date 27.06.2018 (dymije e tetembedhjete), ne zyren noteriale, para meje notere **Diana Hoxha**, anetare e Dhomes se Noterise Durres, me zyre ne Lagjen 4, Rruga: "Skenderbej" Pallati Camera, u paraqien personalisht:---

1) **Paola Minguzzi**, e lindur ne Ravenna (RA), me 26.10.1967, rezident ne Salerno (RA), VIA Degli Angeli, nr 66, qytetare italiane, e identifikuar ne baze te leternjoftimit italian Nr. AT4231398 e vlefshme deri me 26/10/2023 si dhe ne cilesine dhe te administratorit dhe te ortakut te vetem te shoqerise "TOP FORM" shpk, ne baze te vendit te asamblese te ortaleve date 02.06.2018, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e cila ne cilesine e ortakut te shoqerise "**TOP FORM ALBANIA**" **SHPK**, eshte mbledhur me date 27.06.2018 dhe ka hartuar Akt Themelimin e shoqerise dhe pasi e lexoi ate, e nenshkruan pa verejtje duke shkruar emer, mbiemer dhe firme ne origjinale te tij ne kete zyre, para meje Noteres, ne prani te perkthyesit zyrtare te miratuar nga Ministria e Drejtesise, Oert Veizi.

Une, Noterja e vertetoj autenticitetin e nenshkrimit, me cilesine qe me njeh neni 55 i Ligjit nr. 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine".

NOTERI PUBLIK
DIANA HOXHA

